

All-llahu [subhanehu ve teal] thotë: **“Çka kanë ata që të mos i dënojë All-llahu, kur ata janë që pengojnë (të tjerët) nga xhamia e shenjtë (Qabja), e edhe pse nuk janë mbikëqyrës të saj. Kujdestarët e saj janë vetëm ata që ruhen (të devotshmit), por shumica e tyre nuk është që di.”** (El-Enfal-34)

Motra ime!

A e di se cila është begatia më a madhe e All-llahut ndaj teje? E ajo është begatia e Islamit. All-llahu [subhanehu ve teal] thotë: **“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islam in fe.”** (El-Maide 3).

Kuptimi i Islamit është: Dorëzimi All-llahut [subhanehu ve teal] d.m.th. që t’ia dorëzosh vetveten Atij [subhanehu ve teal], poashtu duhet të dish se Ai është Krijuesi, Furnizuesi dhe Zoti yt, të Cilin e adhuron, e nëse vjen urdhëri prej All-llahut [subhanehu ve teal] detyrohesh të thuash: Kam dëgjuar dhe i përgjigjem.

„Kur thirrën besimtarët për gjykim ndërmjet tyre te All-llahu dhe te i dërguari i Tij, e vetmja fjalë e tyre është të thonë: „Dëgjuam dhe respektoam!” Të tillët janë ata të shpëtuarit.” (En-Nur 51).

Motra ime!

Kush të ka urdhëruar për mbulesë?

Me të vërtetë Ai është All-llahu [subhanehu ve teal], i cili të ka urdhëruar me namaz, agjërim, haxh... Motër e dashur! Ti nuk u mbulove që të jesh e bukur, e as për atë se është traditë, apo respekt ndaj burrit apo të fejuarit tënd, poashtu nuk e ve për hirë të askujt. Mirëpo ti mbulesën e vëndove në shenjë adhurimi dhe respekti ndaj All-llahut, Krijuesit tënd.

Motra ime!

Përse e dëshiron mbulesën?

Për arsye se ti je një grua muslimane e pastërt dhe nuk pranon të shikojë në ty askush prej njerëzve. Poashtu ti je grua besimtare e ndershme, refuzon që ta bësh trupin tënd artikull që ta rrotullon e ta

shikon atë kush të dojë! E me këtë rast syri bënë amoralitet me shikimin në trupin tënd. Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem] thotë: **“Sytë bëjnë amoralitet, e amoraliteti i tyre është shikimi”** (Buhariu dhe Muslimi).

Me të vërtetë mbulesa është mbrojtje (nga haramet), pastërti, nderë, moral dhe turpësi. Por parasëgjithash ajo është adhurim dhe nënshtrim ndaj All-llahut [subhanehu ve teal]. Kur All-llahu [subhanehu ve teal] të ka obliguar mbulesën ka dëshiruar ta sprovtoj besimin tënd, të pastrojë, të shtojë nderin, mbrojtjen dhe të ngritë pozitën tënde. Poashtu All-llahu [subhanehu ve teal] ka dëshiruar që përmes mbulesës të ndaloj çdo shikim mashtrues nga lakmia në ty.

Motër margaritare!

Falënderoj All-llahun që të ka obliguar me mbulesë! Mbulesa është fshehje e bukurisë dhe mbulesë e pjesëve të turpshme, për arsye se e gjithë gruaja është e turpshme ashtu siç ka thënë Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem]: **“Gruaja është e turpshme e nëse del e zbuluar e ka parë atë shejtani dhe e ka zbuluar në sytë e njerëzve”**. Nuk është mbulesa veç mbulim i kokës. Mbulesa është që gruaja ta mbulojë tërë trupin e saj. Poashtu mbulesa është virtyt i ndershëm, turpësi, moral dhe mbrojtje. Parasëgjithash, ajo është shkak për afrim tek All-llahu [subhanehu ve teal] me atë çka e don Ai, e All-llahu [subhanehu ve teal] e don pastërtinë dhe turpin, kurse i urren të këqijat, mëkatet dhe zbuluesën.

Si duhet të jetë mbulesa?

Mbulesa duhet të jetë ashtu siç ka urdhëruar All-llahu [subhanehu ve teal] dhe ashtu siç nuk lejohet të falësh me asnjë metodë tjetër përveç ashtu siç të ka urdhëruar All-llahu. Poashtu nuk lejohet të veshësh mbulesë tjetër përveç ashtu siç ka urdhëruar All-llahu [subhanehu ve teal] dhe Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem].

Motra ime!

Të porosisë që t’iu përmbahesh këtyre cilësive dhe kushteve të mbulesës:


E para: Që gruaja të mos vesh rrobe të zbukuruara (shikimnxitëse), për arsye se All-llahu [subhanehu ve teal] e ka obliguar gruan që ta fshehë bukurinë e saj. All-llahu [subhanehu ve teal] thotë: **“Dhe mos t’i zbulojnë stolitë e tyre”** (En-nur 31). Nuk lejohet që gruaja të vesh rrobe të ngushta, të holla, të shëndritwse ose në ato rrobe ka pjesë shëndritwse. Poashtu nuk lejohet që ngjyra e rrobeve të jetë tërheqëse.

E dyta: Detyrohesh që rrobat të jenë të trasha dhe të padukshme, për arsye se rroba e tejdukshme nuk është mbulesë në relitet. Madje mundet që ajo e cila ka veshë këso llojë rrobesh të jetë e mbuluar formalisht, por në realitet është e zbuluar. Pra, kush e bënë këtë ajo është e mallkuar ashtu siç ka thënë Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem]: **“Do të ketë në fund të popullit tim gra të veshura e në realitet të zhveshura, flokët e tyre do të jenë sikurse gungat e shpinës së devës, mallkoni ato sepse ato janë të mallkuara”** (Transmeton Taberaniu, kurse e ka vërtetuar shejh Albani, All-llahu e mwshiroftw!).

E treta: Që të jenë rrobat e gjëra jo të ngushta, poashtu nuk lejohet të përcaktohet diçka nga trupi i saj, e nëse ndodhë kjo atëherë ajo është e mbuluar formalisht, mirëpo e zbuluar në realitet.

E katërta: Që rrobat të jenë mbulesë për tërë trupin, nuk lejohet që të shihet diçka nga trupi i saj për arsye se i gjithë trupi i gruas është i turpshëm. Pra, nuk lejohet psh: që të shihen këmbët e saja apo një pjesë e këmbëve ashtu siç ndodhë tek shumica e grave në këtë kohë.

E pesta: Që mos të përngajnë rrobat e saja me rrobe të burrave, për arsye se All-llahu [subhanehu ve teal] e ka mallkuar gruan, e cila iu përgjan burrave. Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem] thotë: **“E ka mallkuar All-llahu burrin, i cili veshë rrobe të grave, dhe gruan, e cila vesh rrobe të burrave”** (Ebu Davud)



dhe Hakimi).

Gjithashtu nuk i lejohet gruas që të vesh pantollona dhe të del me ta pa pasur diçka mbi ta. E nëse janë veç pantollonat nuk është mbulesë sipas Islamit. Poashtu në të ka përngjarje me burrat. I lejohet gruas që t'i vesh pantollonat nëse vesh mbi ta mantil apo fustan të gjatë ose në shtëpinë e saj.

E gjashta: Që rrobet e saja të mos iu përngjajnë rrobeve të pabesimtareve. Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem] thotë: *"Kush i përngjan një populli ai është prej tyre"* (Ebu Davudi). Nuk lejohet që gruaja të vesh veshje të murgeshave, edhe nëse është mbulesë pra, nëse gruaja e bënë këtë iu ka përngjarë pabesimtareve.


E shtata: Nuk i lejohet gruas që të përdorë parfumë po edhe nëse dëshiron me këtë të dalë prej shtëpisë në xhami. Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem] thotë: *"Nëse një grua parfumoset dhe kalon pranë disa njerëzve e ata e ndiejnë aromën e saj ajo është e pandershme"* (Ahmedi, Nesaiu, dhe Hakimi).

E teta: Nuk i lejohet gruas që të përdorë manikyrë apo t'i zgjatë thonjtë përarsye se kjo është prej të ndaluarave.

E nënta: Nuk i lejohet gruas që të vesh take ose këpucë tjera që kërcasin gjatë ecjes. All-llahu [subhanehu ve teal] thotë: *"Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësitë nga stolitë e tyre"* (En-nur 31).

E dhjeta: Nuk i lejohet gruas që ta ngritë zërin e saj, të qesh me zë të lartë, apo ta zbukuron zërin e saj e as mos të llastoj në fjalët e saja. All-llahu [subhanehu ve teal] thotë: *"O gratë e Pejgamberit, ju nuk jeni si asnjë grua tjetër, nëse keni kujdes e ruheni, andaj mos u llastoni në të folur e të lakmojë ai që ka sëmundje në zemrën e tij, po thuani fjalë të matura."* (El-Ahzab 32)

Poashtu, nuk i lejohet gruas që të anon (dredhohet) në ecjen e saj ose çdo ecje e cila tërheq shikimin e njerëzve, e gjithë



Klubi studentor

kjo i takon zbulesës, të cilën e ka ndaluar All-llahu [subhanehu ve teal].

Së fundi motra ime: Mbulesa është urdhër i All-llahut [subhanehu ve teal] dhe Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve selem]. Çdo gjë që e ka urdhëruar All-llahu [subhanehu ve teal] dhe Pejgamberi i Tij është mirë për ty, e nëse mendon diçka tjetër përveç kësaj veç menduar keq.

Motra ime!

Nëse dëshiron daljen nga shtëpia përkujto fjalën e All-llahut: *"Dhe mos t'i zbulojnë stolitë e tyre"* (En-nur 31). Pastaj pyete vetveten: A e kam fshehur stolinë time apo jo? Nëse është përgjegjja "po", veç e ke kënaqur Zotin tënd, pastaj edhe All-llahu [subhanehu ve teal] do të kënaqet me ty. E nëse është përgjegjja është "jo" veç e ke hidhëruar dhe i ke bërë mëkat All-llahut [subhanehu ve teal], atëherë mos e fajëso askënd përveç vetveten tënde!

"Me këtë këshillohet ai që prej jush e beson All-llahun dhe botën tjetër, kjo është më e dobishme për ju, më e pastër, se All-llahu e di, e ju nuk e dini." (El-Bekare: 232).

Përktheu:
Lulzim Murseli

Marrë nga <http://www.ankebut.com/>

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare

Klubi Studentor

Rr. Stiv Naumov 7 / 18

Tel. ++389 (02) 32 23-654

1000, Shkup



Letër
dërguar
tek çdo

muslimane

